



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmentant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPSDPLS.nr.20/2024

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj Përmbaruesit Privat si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr.287/2023, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Politika të sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika - Divizioni për Profesione të Lira, Burbuqe Spahija Kërveshi, Përmbaruesi Privat në prezencën e palës ankuese , nga Komuna e , me datë 09.12.2024, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Politika të sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika - Divizioni për Profesione të Lira, DPSDPLS-20/2024 i datës 20.10.2024, dhe ankesa e paraqitur nga pala ankuese, nga Komuna e e datës, **si të pa bazuara.**

II. Përmbaruesi Privat , si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , **nuk është përgjegjës**

për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përbarimore P. nr. 287/2023.

A r s y e t i m

Me datën 20.10.2024, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë ndaj Përmbauesit Privat, duke pretenduar se përmbauesi privat, ka bllokuar automjetin e tij, i cili automjet është në emër të tij dhe se i njëjti për bllokimin e automjetit të tij ka kuptuar vetëm kur ka shkuar në qendër të regjistrimit për vazhdim të regjistrimit. Automjeti i palës ankuese sipas vet palës ankuese nuk ka qenë objekt përbarimi.

Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Politika të sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe statistika - Divizioni për Profesione të Lira, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar, ndaj përmbauesit privat, lidhur me veprimet përbarimore për këtë lëndë duke mbetur në tërësi pranë raportit të saj të prezantuar në seancën e datës 09.12.2024.

Përmbauesi Privat, si në përgjigjen e dhënë ashtu edhe në seancë ka deklaruar se pala ankuese nuk është palë në procedurë. Automjeti është bllokuar për shkak të rastit ku kreditor është

dhe debitor . Automjeti i bllokuar ka qenë në emër të debitorit, ndërsa për trajtimin lidhur me kërkesën e palës ankuese, nuk ka mundur të veproj, pasi përmbauesi është nën masën e suspendimit.

Përfaqësuesja e autorizuar e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Politika të sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika - Divizioni për Profesione të Lira, ka bërë shtjellimin e Raportit përfundimtar. Po ashtu edhe pala ankuese si dhe përmbauesi privat, kanë mbetur pranë pretendimeve ankimore, përkatësisht përgjigjes, të paraqitura me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore.

Pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar në mënyrë shteruese të gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ashtuqë pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, erdhi në përfundim që Përmbauesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor, vlerësoi pretendimin e palës ankuese se të njëjtit i është bllokuar automjeti edhe pse automjetin lëndor pala ankuese e kishte blerë nga personi i tretë dhe e ka regjistruar në emrin e tij, por tani i njëjti është i bllokuar nga përmbauesi privat. Ky pretendim i palës ankuese është i paqëndrueshëm , ngase nuk është në juridiksionin e këtij komisioni që të vendos për ta

liruar ose jo automatikisht e bllokuar lëndor dhe për më tepër lidhur me periudhën kohore në të cilën është paraqitur ankesa, përmbartuesi lëndor veç është i suspenduar me vendimin e Ministrisë së Drejtësisë, nr.358/2024, të dt.10.10.2024 dhe i njëjti nuk ka mundur ta ndërmer asnjë veprim përmbartimor për gjatë kohës sa ishte i suspenduar.

Andaj, me këtë rast komisioni vlerësoi se përmbartuesi në fjalë, nuk është përgjegjës për asnjë nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së, sepse të gjitha veprimet përmbartimore për rastin për të cilin është paraqitur ankesa, janë në harmoni me dispozitat e LPP-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARTUESIT PRIVAT
DPSDPLS.nr.20/2024 datë 09.12.2024

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor
Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ, bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.